

STAVRI PONE

BORA

Roman

Tiranë, 2007

Redaktor: Granik DANI

Kopertina: Artur SPAHO

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

*Çdo ngjashmëri me ngjarje e persona realë është krejt e rastit.
Autori*

Prindërve të mi

*Ekziston një delir që përballet me dëshpërimin
dhe vdekjen, që sfidon çdo vështirësi e pengesë...*

Stivën Krejn,
shkrimtar amerikan

1

Në faqen e një kodre në lindje të metropolit po hovte një lagje e re dhe pamja i shembëllente një pikturë ekspresioniste të papërfunduar. Gjithkrah syri të kapte një larmi ndërtesash të mëdha e të vogla, me dy, tri e deri në dhjetë kate, disa shumë të bukura e me arkitekturë moderne, me ballkone të ormisura punë e madhe, disa në ndërtim e sipër. Ndërtesat e përfunduara qarkoheshin nga kopshte të sëritura me pemë, hardhi e lule. Lagjja përshkohej nga rrugë të sapoasfaltuara dhe një thurimë rrugicash ende të pashtruara. E tëra dukej si një mozaik i laracuar që përshenjonte një të ardhme të bukur.

Në periferi të saj kryente shërbesat një kishë baptiste e vendosur në një vilë të re, me oborrin të rrethuar me kangiella, lule e voshtra. Në paradhomë ishin dy tryeza me libra e broshura fetare; në mur qenë vënë disa fotografi të veprimtarive të kishës: besimtarët duke kënduar, duke dëgjuar meshën, duke marrë pjesë në ceremoni pagëzimi. Ishin edhe fotografitë e disa të rinjve që kishin frekuentuar kishën dhe tani studionin në kolegje e universitete amerikane.

Salla e predikimeve ishte e thjeshtë, pa ornamente. Në murin ballor ishte një kryq i madh druri. Besimtarët rrinin në karrige me Bibla në duar. Përballë tyre qëndronin pastori, një burrë i moshuar, që fliste anglisht nga katedra e vendosur në një platformë të gjerë, dhe përkthyesi, një djalë zeshkan e simpatik.

- Dhe Pali tha: *Dashurinë ta keni të sinqertë. Urreni gjithçka të keqe dhe bëni vetëm mirë.*

Gjergji Kuman, një riosh i pashëm, flokëzi, me trup atleti, rreth 27 vjeç, xhironte me një videokamerë. Në rreshtin e parë që ulur e motra, Bora, një vajzë 15-vjeçare, me Biblën të hapur në duar, në të djathtë të saj e ëma, që punonte si pastruese e kishës, kurse në të majtë Artur Golemi, një djalosh me trup boksieri, me flokë të gjatë të verdhë, edhe ai me Bibël të hapur në dorë. Gjergji lëvizti nëpër sallë dhe doli në

krye.

Mbajti në fokus të ëmën, pastaj Borën, e cila i buzëqeshi dhe i nxori gjuhën. Ai s'ë prishi terezinë, por vazhdoi. Nxjerrjen e gjuhës do ta priste në montazh. Kështu e kishte ajo, i bënte ndoca lodra të tilla.

Pastori pyeti besimtarët nëse kishte ndonjë që ende nuk e kishte pranuar Jezusin si shpëtimtarin e tij dhe dëshironte ta pranonte. Arturi ngriti dorën dhe u çua. Bora e vështronte shkarazi. Gjergji vuri kamerën në sy.

- U bënë disa javë që vij në këtë kishë, - tha Arturi. - E pranoj Jezusin si shpëtimtarin tim dhe do t'i ndjek mësimet e Tij derisa Ai të më marrë pranë Tij në Qiell...

Fytyra e pastorit mori një pamje të kënaqur. Edhe Bora e shikonte Arturin me gëzim.

- Familja jonë e krishterë u bë më e madhe, - tha pastori. - Shërbesa mbaroi. Grupi i të Rinjve të qëndrojë.

Besimtarët nisën të dilnin dhe Gjergji i filmonte. Pastori e kishte porositur të merrte sa më shumë pamje, se do ta niste materialin në Amerikë. Në syrin e kamerës Gjergji pa Borën duke biseduar me Arturin, i cili u përkul, i tha diçka në vesh dhe ajo qeshi.

Shtëpia përdhese e Gjergjit trysej mes dy vilave madhështore. Vetëm kuzhina dhe një dhomë kishin përfunduar; dy dhoma të tjera qenë ende të pasuvatuara. Pak më tej ndodhej shtëpia e vjetër, e blerë disa vjet më parë, që tani përdorej si depo. Në një anë të oborrit ishte një parg me rërë, pllaka e thasë me gëlqere.

Kuzhina, të cilën Gjergji e kishte lyer vetë, shërbente edhe si dhomë ndenjeje. Në të kishte një divan, një tryezë buke, katër karrige dhe një bufë, të gjitha të vjetra. Gjergji përfundoi së bëri gati kamerën për të shkuar në një dasmë dhe e futi në një kuti kartoni bashkë me disa mjete të tjera. Hyri e ëma, ende e veshur me rrobat që mbante në kishë.

- Gjithë natën do të xhirosh, biro?

- Po, ma. Po ti u lodhe?

- Po, besa. Kisha është e madhe. S'është vetëm salla, por edhe dhomat, oborri...

Ajo u ul në divan e mezi mbushej me frymë. Gjergji e shihte i merakosur.

- Bora nuk erdhi me ty?

- Jo. Pse, s'ka ardhur?

- Jo.

- Ishte në Grupin e të Rinjve. Kur mbaruan, i thashë të vinte drejt e në shtëpi.

Gjergji ndërkohë shihte se mos harronte gjësend. Mori edhe një kasetë e disa bateri rezervë dhe i fut në kuti.

- Më duket se vazhdon të shoqërohet me atë emigrantin, - tha Gjergji. - Edhe sot qenë ulur bashkë. Ai mund të jetë njeri i mirë, po ku i dihet? S'ka punë ajo me të.

- Mua nuk më dëgjon. Ka qenë e urtë, po ka filluar të ma kthejë. - Nëna heshti një grimë e shtoi: - I bleva një fustan te jevga, goxha fustan, por nuk deshi as ta provonte. Nuk na e mban xhepi t'i blejmë rroba në dyqan.

- Ç'është vërteta, ma, edhe ndonjë rrobë dyqani duhet t'i blejmë.

- Është e vogël për t'u veshur me rroba të shtrenjta. As 15 vjeçe s'është, për një muaj i mbush. Paratë i duam për shtëpinë, s'mund ta lëmë në mes. Unë jam e sëmurë dhe pastori më mban për mëshirë. Edhe ti lodhesh.

Ajo u ngrit e bëri të shkante te çesma, por iu morën këmbët dhe desh ra. Gjergji e kapi dhe e ul sërish në divan. Teksa i jepte një gotë ujë, i tha:

- Duhet ta lësh punën, ma. Tani që Bora u rrit, do të shkoj të punoj në Itali a Greqi. Tani vërtet s'bëjmë dot më shumë për të, po për tre vjet ajo shkon në universitet dhe do para. Kemi harxhuar për kurset e saj të anglishtes që në fillore dhe s'mund ta lëmë pa universitet. - Ai i hodhi një sy orës së dorës. - Nejse. Bisedojmë prapë, se u bëra vonë.

Ai nxori një kartëvizitë nga xhepi dhe e la mbi tryezë.

- Numri i lokalit të dasmës. Po pate shqetësim, thuaj Borës të më telefonojë.

Doli në oborr me kutinë në duar, e vuri në zgarën e motoçikletës dhe e lidhi. Ndezi motorin dhe u nis.

Në rrugën kryesore të lagjes ecte ngadalë një veturë, që më në fund ndaloi. Në timon ishte Arturi, në ndenjësën pranë tij Bora. Ai i hodhi dorën në qafë, ia afroi fytyrën dhe e puthi. Pastaj futi dorën nën bluzë, i fërkoi gjoksin e harlisur, i ngriti fustanin dhe i ledhatoi kofshët e gjata e të bukura.

- Sa të dua, Bora...

- Edhe unë...

- Dëgjo, nuk ke dashur asnjë tjetër?

Ajo u drodh dhe e kundroi frymëmbajtur.

- Çfarë?!

- Mos u habit. Një vajzë kaq e bukur... Nuk ke bërë kurrë dashuri? S'të ka prekur kush?

- Ej! Për kë më merr mua?!

Ajo vuri dorën rrëmbimthi te dera për ta hapur. Arturi e përfshiu nga supi dhe e tërhoqi menjëherë. Ajo e mbante fytyrën drejt, megjithatë ai pa se ajo i kishte sytë me lot.

- Më fal. Nuk e kisha me të keq. Ka plot vajza në moshën tënde që kanë pasur të dashur.

- Unë nuk kam pasur.

Fytyra e Arturit u shkri në një buzëqeshje të ëmbël. Kur buzëqeshte, i formoheshin dy gropëza në faqe.

- Bora, jam vërtet i lumtur! Tani u binda që më do vërtet. - Ai dihaste dhe e shihte ngultazi. - Por prova e fundit është nëse vjen të ikim që sonte.

- Që sonte?!

Ajo fërgëlloi dhe shikimi iu tret në zbrazëti, si të ajgëtonte diku diçka sa të bukur, aq edhe të frikshme e të ëndërrt.

- Skafi niset nesër mbrëma, por do të udhëtojmë gjithë ditën për shkuar vendi.

Ai e afroi ta puthte, por ajo u tërhoq instinktivisht. Qëndronte e nemitur, si statujë, gjithë me shikimin të ngulur në zbrazëti, me fytyrën të mërtisur nga një tis zbehtësie të asisojtë që e shkakton vetëm ankthi i një kuturisjeje të marrë.

- Do të vazhdoj shkollën atje?

- Ta pret mendja. Por në vit të parë. Në të dytin s'mund të hysh, se lypset të përvetësosh gjuhën.

- Prova për film mund të jap? Jo për rol kryesor, kuptohet.

- Patjetër. Edhe për rol kryesor. Ti je lindur për yll kinemaje, as që e vë njeri në dyshim.

- Në Krishtlindje luajtëm një dramë në Grupin e të Rinjve dhe pastorit i pëlqeu shumë loja ime. Unë luaja Maria Magdalenën.

- Në Perëndim mundësitë janë pa fund, Bora. - Dukej se ai s'kishte durim ta zgjaste atë bisedë. - Por do të kemi kohë të bisedojmë. Shko tani dhe më 12 të natës të pres këtu. Je e sigurt që vëllai është në dasmë sonte?

- Po.

U dëgjua zhurma e një motoçiklete dhe Bora u tremb.

- Mund të jetë ai! Nise!

Arturi e nisi makinën, por ishte vonë. Gjergji kaloi anash, i pa dhe e ndali motoçikletën disa metra më tej me një çerritje të fortë të frenave. Në kohën që Gjergji frenoi, Arturi i dha gaz makinës dhe e ktheu në një rrugicë anësore. Gjergji u nis në ndjekje të saj, edhe ai me gazin deri në fund, por si eci pak, ndaloi. Pa orën e dorës, tundi kokën dhe mori drejtimin e kundërt.

Vetura vazhdonte të troshitej në rrugën gjithë gropa. Bora mbahej te doreza e derës dhe heraherës koka i çikte tavanin. Në fytyrë e kishte ende hijen zymtane të ankthit zhagmitës të pak çasteve më parë. Arturi uli shpejtësinë dhe ndaloi. Ajo rrinte e shushatur dhe e përhumbur, me fytyrën të njollëruar nga dritat vezullcake të rrugës që e bënë të dukej si një figurë të përrallshme.

- Mos harro pasaportën, dëftesën dhe certifikatat e nderit. Sa ke marrë, dy?

U desh njëfarë kohe që ajo të fliste.

- Po, - tha me një fije zëri. - Një në Konkursin e Debatit në shkollë dhe një tjetër në Grupin e të Rinjve.

- Të shkollës?

- Jo, të kishës. Për atë shfaqjen.

- Eh, kisha... - tha Arturi duke e parë me sytë e tij të përthellët ngjyrë ulliri që i përshkënditeshin nga dritëza e makinës. - Qeshë me fat që e zura dhomën afër asaj kishëze të bekuar... që na njohu. - Ai u përkul dhe e puthi. - Tani nisu. Në orën 12, mirë?

Bora u gëlltit dhe u trand sikur shkuli një thikë nga trupi.

- Mirë.

Zbriti dhe nisi të vraponte. Në dritën e mugët të rrugës Arturi ndiqte me sy trupin e saj të gjatë, të hajthëm dhe përsosmësisht të derdhur.

Bora rrinte shtrirë në kanape me sytë hapur. Në një divan të vjetër flinte e ëma. I hodhi një vështrim s'ëmës dhe u ngrit duke u përpjekur të mos bënte zhurmë.

Doli në sallon dhe filloi të vishej. Nga poshtë divanit nxori një çantë të mbushur dinga. Pastaj ia nguli sytë fotografisë së prindërve në mur. Iu afrua, e puthi, puthi edhe fotografinë e Gjergjit, mori çantën dhe duke tërhequr derën pas vetes me kujdes, doli në oborr.

Arturi ishte në timon. Ajo iu ul pranë dhe zuri të qante. Ai ndali dorën që e kishte gati për të ndezur motorinon.

- Po vazhdove të qash, më mirë kthehu.

Bora fshiu lotët me mëngën e bluzës.

- Jo.

- Do të jesh e lumtur, zemër. Ke besim tek unë?

Bora e pa në sy dhe buzëqeshi përmes lotëve.

- Po.

Ai i shkoi dorën në flokët e dendur, i buzëqeshi me ëmbëlsi, e puthi dhe nisi makinën.

Nëna u zgjua, hapi sytë dhe pa shtratin bosh të së bijës.

- Bora!

Nuk mori asnjë përgjigje. Thirri përsëri, por përsëri heshtje. U ngrit e shkoi në kuzhinë, por Bora nuk ishte atje. Shkoi te dera e banjës, thirri, e hapi, vajza nuk ishte as atje. Shkoi te dritarja e kuzhinës, hodhi një sy në errësirë, thirri, por përsëri heshtje.

Për sekonda të tëra qëndroi si e ngrirë dhe shkoi te telefoni. Mori kartëvizitën që i kishte lënë Gjergji, vuri syzet dhe formoi numrin. Kaloi kohë derisa iu përgjigj një zë.

Dasmorët ishin në qejf - hanin, pinin e këndonin. Vëmendjen e kishin të përqendruar te nusja me dhendrin, të vetmit që po kërcenin.

Gjergji i filmonte. Nusja ishte e bukur dhe për një çast ai përfytyroi sikur nusja ishte Bora, e lumtur me burrin që e kishte marrë me dashuri.

Pronari i lokalit e ndiqte harenë fytyrëqeshur. Ra zilja e telefonit dhe ai ngriti receptorin.

- Po?

- Jam nëna e kameramanit, - dëgjoi një zë të frikur gruaje. - Mund të ma thirrni pak?

- Një minutë.

Gjergji ishte duke filmuar një grup dasmorësh që bënin potere - dy vetë i mbanin gotat me bërrylat të kapërthyer derisa i kthyen me fund, kurse të tjerët flisnin e brohorisnin.

Pronari e kapi Gjergjin nga mënga dhe i bëri shenjë se e kërkonin në telefon. Gjergji shkoi me vrap te banaku.

- Po?

- Bora ka ikur, Gjergji, - dëgjoi mbyturazi zërin e s'ëmës.

Muzika buçiste, ndaj ai i tha t'ia përsëriste fjalët dhe ajo ia përsëriti. Më në fund, me një lëvizje të mpirë, uli receptorin. Fytyra i mori një shprehje të shtangët dhe ndjeu se e kishte të vështirë të vazhdonte punën. Shkoi tek i zoti i dasmës, një plak mustaqebardhë, dhe i bëri shenjë se donte të bisedonte. Plaku e ndoqi.

- Sapo më njoftuan se më ka ndodhur diçka në shtëpi dhe më duhet të iki.

- Aksident?

- Jo.

- Sëmundje?

- Jo.

- Po çfarë?

- Motra... ka ikur nga shtëpia.

- E pastaj? Do të lësh dasmën?

- Kam filmuar që nga fillimi. Dasma është nga fundi.

- Ne do të rrimë gjer më sabah. Po ike, nuk të paguaj. Janë kujtime këto.

Plaku i ktheu shpinën dhe u largua. Gjergji shkoi te banaku dhe i tha s'ëmës se nuk shkonte dot menjëherë. Pastaj mori kamerën dhe vazhdoi të filmonte. Gjithçka iu errësua dhe pyeste veten, Të ketë ikur me atë palaço?!

Kishte nisur të zbardhte. Nga dritarja hynte një dritë e qashtë, e ngarkuar me freskinë e mëngjesit. Nënë e bir rrinin të topitur. Boshësia e shtëpisë pa Borën ishte një emnesë që u përhijonte vdekjen, vetëm se nuk ua thoshin buzët. Nëna përpushej në divan e mbytur në lot, Gjergji ecejakte duke thithur nervoz një cigare.

- Nuk la asnjë shënim?

- Jo.

- Me siguri ka ikur me atë emigrantin. Ishin në makinë bashkë. - Ai u lëshua në karrige. - Dhe thoshte se nuk takohej më.

- Edhe mua ashtu më thoshte.

Nëna fshinte sytë me cepin e sharpës së zezë e shkundulluar nga ngashërimi. Gjergji u ngrit dhe nisi të lëvrinte sërish.

- Iku. E mori. A për grua, a për ç'dreq, ec e gjeje.

- Po bjeri pas... Ja, u gdhi. Ia gjen kollaj shtëpinë.

- Ç'shtëpi, o ma! Ata janë nisur për në Itali. Ku t'i gjej?

Nëna heshti për një çast dhe mezi foli:

- Akoma kalama dhe mendjen te dashuria! Leqë ku e njohu ajo se ç'syfet ishte! Pikë e zezë...

Gjergji ndezi një cigare tjetër. I dukej e pabesueshme që Bora kishte ikur. Gjëra të tilla ndodhnin, por nuk kishte menduar kurrë se mund t'i ndodhte edhe motrës së tij. Gjithnjë kujtojmë se fatkeqësitë u ndodhin vetëm të tjerëve, tha me vete gjithë pezëm.

- Shkojmë në polici, - tha e ëma. - Ajo quhet e rrëmbyer, s'kambushur as 15 vjeçe.

- E çan shumë kokën policia! Do të na thonë se ka ikur me dëshirën e saj, pavarësisht sa vjeçe është. Dhe ashtu është. Idiotja! Si dreqin e bëri këtë? S'e mendoja kurrë!

- Ai s'ka faj?

- E ç'rëndësi ka? Gjete, bëri, s'e mori me zor. - Gjergji nisi të ecejakte sërish nëpër kuzhinë. - S'na ndihmon as policia as Zoti, ma. Nëse dikush duhet ta gjejë atë idiote jemi ne. Me një fjalë unë. Nëmospo sytë të nxjerrë!

- Jo. Aq ia preu kungulli. Po sikur ai ta lërë në mes rrugëve?

- Nuk them atë, o ma, jo! Do të shkoj se s'bën ta kërkoj.

- Si e bëri këtë polmë? O Perëndi! Mori udhët për faqe të zezë... i beson një të huaji... Paska qenë e marrë dhe s'e kemi ditur?!

Pasoi një heshtje e gjatë, e ndërprerë nga ofshamat e nënës. Gjergji u lëshua në karrige, qëndroi pak palëvizur, u shkund e tha:

- Po nisem, ma. Do të marr paratë që kemi hequr mënjanë për shtëpinë.

- Po, o bir. Po.

- Kam dhe hallin tënd! Je e sëmurë. Do të shkosh nga daja?

- Jo. Do të rri këtu.

Ajo vari kokën dhe shpërtheu në dënësia. Gjergji mori një çantë dhe filloi të fuste rroba e sende të tjera. U ngrit edhe e ëma ta ndihmonte.

Ishte një natë e mugët me një qiell të stërpikur yjesh dhe me një det bunacë. Një gjysmëhënë e zbehtë derdhte një dritë të limontë mbi ujanën e pamatë duke pikturuar një kometë të leskëruar me bisht të artë. Në det dukej një skaf që shigjetonte me shpejtësi marramendëse duke lënë pas një vrage të gjatë. Ishte i mbushur dinga, shumica djem të rinj, por kishte edhe burra e gra.

Bora rrinte e ngjeshur pas Arturit me sytë të tretur në atë hapësirë

lemerisht të frikshme. Era ia grafullonte flokët e kretë, por ajo nuk përpiqej t'i rregullonte. Ishte e mpirë, fytyra e ngurtësuar i përvijohet si ikonë, stërklat e suvalave ia freskonin, por përbrenda ndiente një zjarrmi që s'mund t'ia fashiste kurrfarë suvale. I drithërohej zemra tek përfytyronte tronditjen e mamasë dhe të Gjergjit dhe një gjembth i sertë ia çërriste shpirtin. Por s'kishte ç'bënte, s'i ndihmonte dot. Po t'ua kishte thënë ç'kishte vendosur të bënte, ata s'do ta kishin lënë. Ku mund t'i shihnin ata gjërat me sytë e saj! Si mund të arrinin të depërtonin ata në ëndrrat e saj! Fundja kush është ai që arrin të depërtojë në ëndrrat e një tjetri? Përpara saj hapej një jetë e re dhe e bukur, më e bukur edhe se ëndrrat... Fundja, ajo po ikte me të dashurin. Sa e sa vajza kishin ikur me të dashurit dhe të fejuarit e tyre. Dhe i dashuri i saj ishte aq i mirë, e donte me shpirt dhe do ta ndihmonte që ajo t'i realizonte dëshirat e saj. Asgjë e bukur nuk arrihet pa guxim, vazhdonte të fliste me vete, dhe këtë nuk e kishte nga mendja, por e kishte lexuar në një libër. Mami me siguri është bërë pikë e vrer, kurse Gjergji jo dhe aq, se ka mendime të gjera dhe të kohës. Madje, me vete mund të më ketë përgëzuar për guximin, por unë, gjithsesi, një shënim duhej t'ua kisha lënë, por s'di pse kisha një si frikë sikur do të më bëheshin pengesë...

Pas atij lundrimi të rrufeshëm e mendjemarrës, që zgjati thujse aq sa zgjat një ëndërr, në mëngjes u gdhinë në bregun italian. Arturi mori frymë i lehtësuar që u kishin shpëtuar patrullave të tmerrshme të *Guardia di Finanza*. Ai dinte disa shtigje ku nuk mund t'i pikaste policia. Shujtuan njëfarë sille në një barakë lagjeje periferike, jo pa ngjallur kureshtjen e gjindjes, dhe i hipën trenit për në Milano, ku sosën mbrëmënet vonë.

Rrinin në një bar të bukur, gjithë drita e ngjyra. Arturi hante me uri, kurse ajo shikonte aneqark me kureshtje, pa e çarë kokën për të ngrënë. Ra celulari i Arturit. Ai la pirunin, e nxori nga brezi dhe e vuri në vesh.

- Në vendtakimin tonë.

Mbylli celularin, shtiu verë në gotën e Borës dhe filloi të hante sërish.

- Kush ishte?

- Një shok. Do ta takoj për çështje pune.

- Po në shkollë kur do të registrohem?

- Në shtator, se jemi ende në qershor. Këto dy muaj do të mësosh e do të lexosh. Italishtja s'është e vështirë, por edhe ajo do punë, si çdo gjuhë.

- Sa keq që nuk jam marrë me të! Edhe aq sa di, nga televizori e di. Kurse anglishten e kam filluar që në klasë të dytë dhe në Grupin e të Rinjve flisnim vetëm anglisht. - Ajo i kapi dorën. - Do të më shëtitësh në qytet?

- Po. Por më parë duhet të nxjerr një lejeqëndrimi për ty. Policia mund të dyshojë se të kam sjellë për punë të pista.

Ajo e pa me habi dhe vuri buzën në gaz.

- Për punë të pista?! Unë erdha me ty, se të dua!

- Po, vogëlushe, po. Ha tani.

Hyri Serxhi Andoni, një tip i gjatë, hollak, me pamje intelektual, i veshur mirë, që nisi të shihte rrotull. I pa dhe u ul në tryezën pranë. Duke u kujdesur të mos binte në sy të vajzës, i bëri Arturit një shenjë lehtë me kokë.

Serxhi qe diplomuar për elektronikë me nëndegë informatikën. Kishte punuar në një bankë, kishte bërë dy mashtrime në kompjuter, e kishin pushuar dhe kishte shkuar në Itali, ku qe njohur me Artur Golemin, i cili trafikonte femra. Nga Arturi kishte dëgjuar së pari për fitimet përralore që sillte puna e trafikimit dhe e tutorllëkut, çka ia kishte shtënë xixat keq. Qe kthyer në Shqipëri dhe kishte kontaktuar tri femra: një punonjëse banke të re e të bukur, me të cilën kishte pasur marrëdhënie; një shoqe të saj, sekretaren e një presidenti firme, i cili e pallonte përnatë; dhe një komshie të tij, familja e së cilës e merrte bukën me listë. Të tria vajzat kishin pranuar të punonin si prostituta, i kishte çuar në Itali dhe Arturi e ndihmoi t'i sistemonte. U kthye sërish në Shqipëri për të marrë edhe një vajzë me emrin Ema Petani, që sapo kishte mbaruar maturën dhe të cilën e dashuronte, dhe e solli në Itali. Edhe këtë e kishte bërë prostitutë dhe pas njëfarë kohe e kishte bindur të shkonin në Angli. Kaloi në Angli edhe prostitutat e tjera duke i marrë borxh Arturit një shumë të madhe për pasaportat dhe për rrugën nga Franca në Belgjikë e që aty në *Folkstone*. Në Londër qe njohur me një kryebandit dhe qe lidhur me të.

- Do të shkosh nesër në punë?

- Jo. Fabrika është në rikonstrukcion, hapet pas dy muajsh. Fytyrën e Borës e mbuloi shqetësimi.

- Po gjer atëherë si do t'ia bëjmë?

Arturi i buzëqeshi.

- Mos u shqetëso, zemër. Prandaj do ta takoj atë shokun. Kam aq shokë këtu, sa nuk e kam problem të gjej një punë. Unë dua mekanik, në zanatin tim, por mund të punoj edhe në picerri, restaurant... - Përsëri i buzëqeshi. - S'do rrimë pa ngrënë.

Bora heshti dhe filloi të hante. Arturi rrëkëlleu gotën me verë.

Po afronte mesnata. Apartamenti ku banonin ishte i vogël. Bora po bënte dush. Arturi rrinte në kolltuk duke parë televizor. Ishte me kanotiere, çka ia nxirrte më në pah trupin e tij muskuloz, .

Bora doli nga banja e mbështjellë me penjuar. Duke rregulluar paksa flokët e lagur eci me çapa të lehtë, si nimfëz, dhe qëndroi ballë tij. Ai hoqi sytë nga televizori, e vështroi dhe u shastis - ajo rrezëllinte. Dhe vetëtimthi mendoi se apartamenti në të cilin banonte prej kohe kurrë s'i qe dukur aq i bukur - ajo i jepte bukuri gjithçkaje pranë së cilës ndodhej. Në ballë e faqe i ndritnin disa pikla të ylbarta si temina dhe dukej e gjitha si e mbështjellë nga një brerore shendi që i rrënjonte vetishëm, çka ndodh shpesh te vajzat e moshës saj, që janë më shumë fëmijë se të rritura.

- Mund të jap prova për film e veshur kështu?

Ajo bëri një piruetë si të ishte e palëndët.

- Nuk e besoj.

- Në rolin e një vaje romake. Nuk rrinin të veshura kështu gratë romake?

- Rrinin, por i kapnin rrobat me karfica, nuk i mbanin me dorë.

- Ta pret mendja, se ndryshe do t'u binin!

Ajo i hodhi një vështrim të kithhtë, gjithë si lozonjare, dhe e la rrobën të binte duke lëshuar një Ah! Ai mbeti gojëçapëlyer. Ua nguli sytë gjinjeve të saj të ardhangët, belit të hollë, kofshëve të hatashme dhe deltës së pubisit. Ishte vajzë e vogël, por në sarkën e saj nuk kishte asgjë vogëlane - gjithçka ishte e arrirë, një mrekuilli shpirtrrëmbyese e përplotë.

- Po kështu?

Ajo dukej vërtet çapکہne. Ai buzëqeshi.

- Për filma pornografikë?

- Çne! Unë u zhvesha... për ty. Nuk më ke parë asnjëherë kështu...

Ajo e ndiente turpin që ia përsquqte fytyrën, por valoma e dëshirës kishte dalë më e fortë. Ndiante gjithashtu se nuk e kishte të lehtë ta

ruante pamjen gazmore, që tani po i tretej duke iu kthyer në kërkesë, në ngulm, çka shihej në sytë e saj të bukur e të perënduar, në pushtetin e pasionit që ai ta rrëmbente, ashtu picake siç ishte, dhe të bënte me të çka ajo e donte aq shumë, që e kishte ëndërruar kaq herë me frikë e ngazëllim në fantazinë më intime dhe që në banjë, teksa prekte pjesët më erogjene, e ndiente bërtitëse atë dëshirë që i shkallmonte turpin, ngurrimin dhe frikën.

- Ti vetëm më ke puthur, asgjë tjetër...

Ai e shikonte i hutuar duke ndier fallusin t'i pulsonte, por nuk lëvizti. Gazi u shua në sytë e saj dhe ai pa se ajo ishte gati t'ia plaste të qarit. Dukej se turpi po e mundonte vërtet.

- Nuk të pëlqej?

Ai nuk e pati të lehtë të fliste. Ziente nga pasioni dhe e kishte të vështirë të gjente fjalët e duhura për të fshehur dhimbjen e mposhtjes së tij, pasi nuk ekzistojnë fjalë që të jenë të afta të mohojnë, natyrshëm e pa shtirje, përmasën e një dhimbjeje të tillë.

- Ç'thua, Bora! Si mund?... O Zot! Ti je e përkryer!

- Atëherë pse nuk më ke zhveshur asnjëherë?

Ajo iu hodh në prehër dhe i ngjiti buzët. Ai ndjeu amësimin e lëkurës së saj, ngrydhtësinë e gjinjve të saj, hamgjitjen shungulluese të kurmit të saj që rrënjonte epsh e përgjërime dhe ia kafshoi buzët e plota, ia kafshoi thimkat e rozta, puthi lugajën e qumështuar mes gjinjve të saj gufmues dhe zhyti kokën në pubis. E shakmisur nga një drithëritë e paprovuar, ajo e kapi nga dora, e tërhoqi në shtrat dhe duke u shkundulluar nga padurimi nisi ta zhvishte.

- Turi, shpirt...

I hoqi kanotjeren dhe u bë gati t'i zbërthente rripin e pantallonave me buzët të ngjitura parzmit të tij. Ai i ndaloi përkëdheljet dhe duke bërë disa lëvizje të buta iu shkëput.

- Bora, nuk... Nuk duhet...

Ajo mbeti shtang dhe fytyra iu kthye e gjitha në pikëpyetje. Ai e pa mirë se sa ishte prekur, i pa edhe sytë që i shkëlqenin nga zemërimi. Ajo mbuloi me çarçaf bukurinë verbuese të lakuriqësisë së saj, vuri bërrylin mbi jastëk dhe mbështeti faqen në dorë. Në sy i ndritnin lot.

- Pse s'do? - pyeti me një fije zëri.

- Je e vogël.

Ajo u kapllua nga një valë inati.

- E vogël?! Disa shoqe të mia e kanë bërë që dymbëdhjetë vjeçe. Në

Shqipëri nuk më more asnjëherë në dhomë. Më do apo jo?

- Si s'të dua! Mos të të doja, pse do të të merrja këtu? Ti je perla ime... dashuria ime... Por je ende e vogël.

Ajo nuk ia shqiste sytë dhe e hetonte me vëmendje.

- Jo, nuk është puna aty. - Lotët nisën t'i rridhnin faqeve. - Nuk të pengon mosha ime. Diçka tjetër ke, po se çfarë, nuk e di.

Arturi mbeti i çmeritur me intuitën e saj. Ajo nuk e dinte se ai kishte luftuar gjëmshëm me vete, se nga e njëjta çmendje që pushtuar edhe vetë dhe do të kishte dashur t'ia bënte deri në mëngjes duke e shkallmuar me puthje e ledhatime e kafshime, me nga një gotë shampanjë në mes, por nuk mundej dhe, ç'ishte më e keqja, nuk ia thoshte dot përse.

- Mirë, - tha më në fund. - Do ta bëjmë, po jo tani, se nuk kam prezervativa. Në fakt, nuk mbaj.

- E ç'ë? Po tregove kujdes, nuk ndodh asgjë. Një shoqja ime ashtu e bënte. Thoshte se ashtu është më qejf.

- Paska qenë dreqi vetë! Nuk tallej me ty që nuk e kishe bërë?

Borën e përshkoi një valë krenarie.

- Tallej, po ia tregoja qejfin. Kushdo mund ta bëjë, - i thosha, - por puna është ta bësh me atë që dashuron. - Ajo e uli zërin. - Ajo e bënte me shumë djem, edhe me një burrë të martuar.

- Pa, pa, pa! Shyqyr që nuk të bëri edhe ty si veten.

- Mua?! Kurrë. Vetëm më thoshte pse nuk zija një të dashur. Sikur ishte zor i madh. Sa çuna më vinin pas...

Ra zilja e celularit të Arturit. Ai e mori nga tryeza, pa se kush i telefononte, e vuri në vesh dhe dëgjoi.

- Në rregull. Tani po vij.

Ai i hodhi Borës një vështrim të ëmbël e i tha:

- Dëgjo, zemër, më duhet të dal. Nuk do të mërzitesh?

- Do të mërzitem. Pse do të dalësh?

- Për problemin e punës. Ka shumë rëndësi.

- Edhe unë kam rëndësi.

Ai u përkul dhe e puthi. Ajo i hodhi duart rreth qafës dhe nuk i shkëputej. Ai e shmangu butësisht, e kapi nga mjekra dhe i tha:

- Puna ime lidhet edhe me ty, shpirt!

Ai filloi të vishej. Borës iu rënduan sytë nga gjumi, vuri dorën përpara gojës dhe foli duke gogësitur:

- Dhe mos harro të marrësh nga ato dreq prezervativa.

Arturi ia shtypi hundën lehtë dhe atë e zuri gjumi. Ai nuk lëvizi, por e kundronte si i mesmerizuar. Gjumi retushoi tek ajo çdo grimë pakënaqësie dhe i dha magjisë së saj një përmasë të përrallshme. Një bukuri të tillë ai nuk e kishte parë kurrë.

Rrinte ulur me Serxhi Andonin në po atë lokal ku kishte ngrënë darkë me Borën. Të dy kishin përpara pije e meze, por asnjëri nuk i prekte. Dukej që qenë degatur goxha dhe ishin të dy të erethisur.

- Po i bie drejt: ndërrova mendje.

Serxhi e vështroi syzhgapërruar.

- Ke luajtur mendsh?

- Jo.

- Po ne kemi rënë dakord, si herët e tjera. Ç'ndryshon këtë herë?

- Do ta anuloj marrëveshjen dhe do t'ju paguaj dëmin.

- Dëgjo, kaqol, mblidhe mendjen. - Ai kërcëlliti dhëmbët dhe flaku pirunin. - Do të futesh në telash, dhe jo me mua. Ne mund t'ia falim shoqi-shoqit ndonjë shkelje në kallo, por me atë është ndryshe.

Ai hurbi një gllënjë verë, hëngri pak biftek e vazhdoi: - Dënimi është me vdekje dhe për ekzekutimin tënd do të më caktojë mua. Unë do t'i them, Nuk e vras dot, dhe ai do të caktojë një tjetër. Nuk ta rrok truri këtë? Apo të duket e pabesueshme.

Ishte hera e parë që Arturi e hante fjalën. Serxhi habitej se si ai njeri, bashkëpunëtor me përvojë, e kishte marrë kaq lehtë, kur në këtë mes nuk ishte më ai, si Serxh, por një tjetër. Kërkonte si trap anulimin e marrëveshjes dhe gjithçka, sipas tij, do të mbyllej paqësisht. Diçka vërtet për të qeshur.

- Po si drejtin e mori me aq qejf? - Zëri i Arturit tingëlloi gjithë pezëm. - Mjaftojnë disa mut foto në një mut ekрани për të gjykuar për paraqitjen e një femre?

- Nuk u mjaftua me to, o zybë. Unë pse erdha? E pashë dhe me t'u ndarë me ty, e mora telefon. Ia përshkrova pa zbukuruar asgjë. Ai ra dakord, la çmimin në fuqi dhe e quan të përfunduar. Fjala e tij është ligj.

Arturi rrinte tërë turinj, i zhytur në vramendje, i zënë ligisht, ndonësee kuptonte që ajo gjendje e amullt e tij s'mund të vazhdonte pafundësisht. Më në fund u shkund e tha:

- Dëgjo, Serxhi... Ajo nuk është e virgjër.

Serxhi ngriti kokën ngadalë, si të kishte dëgjuar gjënë më të

pabesueshme në jetën e tij dhe i dokëndisur keq, i fyer gjer në palcë, por i përmbajtur, duke u mjaftuar vetëm me një kërcëllimë hakërruese në zë, ia ktheu:

- Ti më the se është e paprekur.

- Po. Sepse ashtu e dija. Përherë më thoshte se nuk e kishte prekur njeri, kurse mbrëmë më tha se e kishin palluar që të vogël.

Serxhi vazhdonte ta shikonte sypicërruar dhe për disa çaste nuk qe në gjendje të fliste.

- Po këtë ta kishe thënë të parën. Për virgjërinë ai të ofroi atë çmim, se femra të shpuara gjen plot. Pse s'e zbulove në kohë?

- Unë s'jam doktor, që ta vizitoja. Ku e tregojnë vajzat këtë?

Serxhi nuk e pati më në dorë të mposhtte valën e tërbimit.

- Ishte puna jote. Ai më dërgoi sipas fjalës tënde dhe ardhja ime këtu është një djall me shpenzime. Do t'ia paguash një për një, plus gjobën, që është sa çmimi. Ndryshe, të pret plumbi.

Arturi u vuvos. S'ishte ndodhur kurrë në një situatë të tillë të pjerdhur. I kishte rastitur të anulonte marrëveshje, dikë e kishte ngrënë në besë, por një trysni të tillë s'ia kishte bërë kurrkush. Nëse Serxhi fliste seriozisht, bos i tij duhej të ishte paranojak. Për një copë herë ndenji pa folur dhe i dha karar të përdorte taktikë tjetër.

- Në fakt... e virgjër ishte.

Serxhi u pataks fare. Shuku për tryeze gotën dhe e vështroi Arturin si të mos u zinte besë syve a fliste përnjëmend apo mahitej.

- E paske palluar vetë. Kur e doje për vete, ç'mutin ma propozove?

Arturi e gëlltiti fyerjen. E dinte që Serxhi ishte dorësertë, megjithatë, në rrethana të tjera, nuk do t'ia përtonte t'i fuste një plumb kokës, edhe pse njiheshin prej kohe. Por këtë radhë i kishte ngecur sharra në goxhdë.

- Më ra në kokë më pas. Një punë muti e tërë. Ti e di sa femra kam, por asnjë s'është si ajo.

- Dëgjo, - foli Serxhi ftohtë. - Meqë e do për vete, mbaje, po s'duhej të kishe hyrë në pazar për të. Kjo rënie në kokë mund të jetë arsye për ty, po jo për bosin tim.

Ai bëri të ngrihej, por Arturi e kapi për mënge dhe ia nguli sytë me një pamje të zgërlaqur.

- Më kupto, Serxhi. Ky rast është ndryshe...

- Për ty, ndoshta. - Serxhi iu shmang dhe u ngrit. - Ai të vret për hiçgjë, pale kur ka një arsye. Me të mira.

Arturi brofi në këmbë, e kapi sërish dhe e uli. Biseda për Serxhin kishte mbaruar, por nuk ia prishi tjetrit për hir të njohjes së vjetër.

- Më ndihmo t'i paguaj vetëm shpenzimet e ardhjes tënde, jo gjobën.

- Dhe gjobën ta paguaj unë? Hajde shok, hajde!... Pastaj, nuk e kupton se në lojë nuk është gjoba, por koka jote?

Arturi ishte i bindur se po të donte, Serxhi mund të ndikonte te bosi i tij jo vetëm për të mos e ekzekutuar, por edhe për t'i falur gjobën. Mirëpo ai po tregohej aq i ngushtë, sa e urreu.

- Po të duash, ti manovron. Për hir të miqësisë.

- S'bëhet ajo. Dhe më lër të iki, se nesër marr avionin.

- Dëgjo, unë s'e kam prekur. Po sikur të jetë e palluar që më parë?

- Nëse më betohesh që s'e ke prekur, vë nderim tim si garanci. Nëse më mashtron, do ta hash plumbin nga unë.

Arturi heshti. Kishte luajtur me zjarrin dhe kishte rënë vetë në zjarr. Nuk qe ndier kurrë si atë çast, nuk e kishte provuar kurrë se ç'ishte thagma e një ndarjeje që barabitej me vdekjen. Kishte dhe një kartë, të fundit, të cilën e hodhi.

- Ajo ka një vëlla dhe me sa pashë, nuk m'u duk qulls.

Serxhi u gërbuz. Dhe aq tallëse ishte skilifaca e tij, sa Arturi gati ia veshi me grusht.

- Kur qenke dhjerë në brekë prej tij, si guxove t'ia hidhje të motrën në treg?

- Nuk u dhjeva. Të dhitesha nga burrat dhe vëllezërit e femrave që kam, s'do të isha ky që jam.

- As bos i nuk pjerdh shumë, por lëmë të iki.

- Serxhi, të lutem, më ndihmo.

- Ndihma ime është të të bëj një pyetje të fundit: e shet apo jo.

Arturi lëshoi një psherëtimë dhe i ra tryezës me grusht aq fort, sa gjithë sendet mbi të zhangëllinë dhe disa klientë kthyen kokat.

- S'e prisja nga ty, Serxhi. Merreni. Merreni dhe shpartallojeni, kusur mos i lini.

- E dimë vetë se ç'bëjmë ne, por dëgjo: shpenzimet për blerjen e pasaportës, për ndërrimin e fotografisë dhe për udhëtimin e saj janë të bosit. I japim fund?

Arturi foli me një zë të zvergur si të vinte nga përtejvarrit.

- Po.

Serxhi i zgjati dorën dhe u ngrit. Arturi qëndroi i palëvizur dhe u shkund vetëm kur erdhi kamerieri.

Hyri në dhomë pa u ndier. Televizori ishte i ndezur pa zë. Ai shkoi pranë shtratit dhe pa se ajo flinte. Si do të ndahem me të, o Zot, i shpelloi një zë në boshëtirë. Fytyra e saj engjëllore me ata flokë të perënditur në nënkresë dhe njëri gji i zbuluar si përfëllimë e djelltë ia hoqën trurin krejt. Mezi i bëri ballë dëshirës së çmendur për ta puthur.

Ajo u zgjua, lëshoi një britmë gëzimi, cangëloi kurmin dhe i hodhi duart në qafë.

- Më kishte zënë gjumi...

Arturi statujëronte bri saj me fytyrën të shtangësuar në një kërveshje idiooteske. Ajo pati ndjesinë se diçka e keqe do t'i kishte ndodhur. Fytyra iu murrëtye dhe mezi e pyeti nga frika e përgjigjes gjëmëtare që priste të merrte.

- Ka ndodhur gjë?

- Fabrika do të mbyllet. Por besoj se do të gjej një punë...

Megjithëse priste diçka shumë më të keqe, edhe ajo përgjigje e shqetësoi.

- Gjen dot?

- Patjetër.

- Atëherë pse je kaq i mërzitur?

- Ashtu të dukem?

- Ua! Ti je bërë dyllë... Unë thashë ç'të ka ndodhur.

Ajo e tërhoqi nga dora në anë të krevatit.

- Nesër do të marr shtëpinë në telefon që t'u them se ku jam. Me siguri ata po luajnë mendsh nga merak...

- Hëpërhë jo, Bora. Më vonë.

- Pse?

- Sepse të kam marrë pa pëlqimin e tyre. Me të marrë vesh se ku je, i telefonojnë policisë italiane. Mua më fusin në burg për rrëmbim personi dhe ty të riatdhesojnë.

Bora ndenji e menduar për disa çaste.

- Po ata do të jenë bërë shumë merak. Kur do t'ua them?

- Pas ca kohe. Ndryshe unë fikem.

Ajo hodhi shikimin nga dritarja, ku dukej një cep çatie i ndriçuar, degët e laracuara të një pische dhe një kullë e përndritur diku larg, përmbi konturin e errët të ndërtesave.

- Do të flemë bashkë?

- Patjetër. Po bëj një dush dhe erdha.

Ai bëri të ecte drejt banjës, por pyetja e saj, More nga ato dreq prezervativa?, e gozhdoi në vend. Ai u kthye, i shkoi pranë dhe u ul në anë të shtratit. Bora, do të të them diçka. Kur më pyete pse nuk bëj dashuri me ty, unë nxora si arsye moshën tënde dhe ti dyshove me të drejtë. Sepse e vërteta është gjetkë. Ajo e vështronte syçakërritur. Shumë femra i sjellin këtu për prostitucion. Kjo nuk ka të bëjë fare me ne, mirëpo policia mund të dyshojë, na kap, ty të çon te mjeku dhe poqese nuk del e virgjër, mua më fusin në burg. Ne do të themi se duhemi, po ku do t'ia dijë policia! Virgjëria jote është mbrojtje për ne. Kupton?

Ajo qëndroi gjatë në heshtje. Fytyra filloi t'i zbutej, madje t'i merrte një shprehje të ngrohtë e të çliruar nga ankthi.

- Kjo nuk do të vazhdojë gjatë. Unë të dua dhe s'mund të rri pa bërë dashuri me ty. Po pse të mos durojmë edhe pak, përderisa kemi ardhur për qëllime të pastra?

Bora tundi kokën në shenjë pohimi.

- E kuptoj. - Ajo u pushtua nga një dallgë emocioni të çiltër. - Sa i mirë që je, Turi!

Ajo i hodhi duart në qafë dhe e shtrëngoi fort.

- Kemi tërë jetën përpara për të bërë dashuri, Bora.

Ai e puthi dhe ajo iu lëshua në kraharor e lumtur. Ajo ishte ende e përgjumur dhe fjeti në krahët e tij me po atë buzëqeshje fëminore në fytyrë. Ai e shtriu me kujdes, pa ia ndarë sytë, i pushtuar nga një ndjenjë e thukët pendese dhe urrejtjeje për veten.

Ajo rrinte në po atë bar dhe herë pas here shikonte orën e dorës, që ia kishte blerë Arturi për 3 euro. Më në fund e pa të hynte dhe gati briti nga gëzimi. Por gazi iu fashit, madje ndjeu një krepatim të thekshëm kur pa se Arturi ishte pikë e vrer. Ai u ul pranë dhe grafulloi. Bora e shihte me gjak të ngrirë.

- Ka ndodhur gjë?

- Fabrika nuk do të mbyllet, por mua më shkurtuan.

Si dhe një natë më parë, Bora kishte pritur diçka më të kobshme, ndaj u ndje disi e lehtësuar.

- Ti mbrëmë the se nuk e ke problem të gjesh një punë tjetër.

- Të them të drejtën, Bora, doja të të qetësoja ty, por nuk është e lehtë. - Ai ia nguli sytë pikëllueshëm dhe vajza u ligështua sërish. - Nja dy shokë më këshilluan të shkoj në Angli, se atje paska punë plot.

Mua s'më prish punë ta provoj, por kam hallin tënd. Nuk kthehesh më mirë në shtëpi?

Bora e pa e ankthëruar, me fytyrën dyllë.

- Jo. Do të vij me ty. Më merr dot? Mund të vij?

- Edhe unë dua me gjithë shpirt të vish, Bora, por ka shumë pengesa. E para, s'ke pasaportë. Mund të kalojmë edhe në rrugë ilegale, por është e rrezikshme, mund të na kapin. Pa një pasaportë të rregullt italiane është thuajse e pamundur.

Ajo u bë pikë e vrer dhe sytë iu rrëmbushën nga lotët.

- Pra, nuk vij dot?

Ai shikonte anash dhe kafshonte njërin cep të buzës, i menduar.

- Meqenëse ke kaq shumë dëshirë... do të bëj çmos. Do të përpiqem të të gjej një pasaportë italiane, megjithëse kushton një djall e gjysmë.

- Po ti s'ke para, - i tha ajo zemërlëshuar.

- Do t'i gjej borxh. Kur të filloj punë, i laj. Puna është se...

- Nuk gjen dot vizë?

- Jo, nuk duhet vizë. Puna është se unë të mora për të jetuar në Itali, jo në Angli. Më duket sikur po të ha në besë. Sikur të kthehesh në shtëpi?

- Jo. Nuk dua të ndahem nga ty. Nuk dua. Vetëm nëse të bëhem barrë dhe... dhe ardhja ime ka shumë shpenzime...

Ajo u përlot dhe fshiu sytë me një kartëpicetë.

- Ti nuk je kurrë barrë për mua, Bora. Gjithçka që kam, të përket edhe ty. Sepse të dua. Pra, e ke mendjen top të vish në Angli?

- Po. Kudo që të jetë. S'ka rëndësi se ku, mjafton të jem me ty.

- Në rregull. Do të bëj çmos të të marr. Nëse s'të marr dot, do të kthehem në dy në Shqipëri.

- Jo. Nëse s'më merr dot, ti ik. Mbase mund të më marrësh më vonë. Apo do të më harrosh?

- Të të harroj ty?! Kurrë. Unë të dua shumë, Bora. Mbase na ndihmon Zoti dhe ia dalim.

Ajo mori frymë e lehtësuar.

- Do të kem mundësi të ndjek shkollën atje?

- Patjetër. Ma merr mendja se ti di aq anglisht sa të vazhdosh vitin e dytë të shkollës së mesme, apo jo?

- Besoj se po. Por edhe do të mësoj shumë. Shumë.

Ai e kapi nga dora dhe i buzëqeshi me ëmbëlsi. Serxhi rrinte ulur në një tryezë më tej dhe nuk ua ndante sytë.